

AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE “ 2H-STUDIO ” SH. P. K.

Në Tiranë sot më date 16.11.2024, une i nenshkruari :

Z. Levend Harizi, i datëlindjes 01.05.1969, lindur në Tepelenë dhe banues në Tirane, Rruga Robert Zhvarc, Nd. 8 Hyrja 1, Njesia Administrative Nr. 5 ,1019, Tirane me Kartë identiteti Nr. G905012650.
me cilësinë e ortakut te vetem themelues;

Mbeshtetur në Ligjin 9901 datë 14. 04. 2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 date 03. 05. 2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”, krijon shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, te emertuar:

“ 2H-STUDIO ” sh. p. k.

KREU I

NENI 1

KRIJIMI

Shoqëria “ **2H-STUDIO** ” shpk është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur Shoqëria).

NENI 2

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet e procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkatuara gjatë veprimtarisë së saj.

Kapitali i Shoqërie ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetëm, që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

NENI 3

SELIA

Shoqëria e ka selinë në adresen : Pallate Derveni, Kulla 5 , Kati pare Nr. Pasurie 426/105-N16, Tirane. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hape zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Ortakut të Vetëm.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

● Ne fushen e projektimit dhe zbatimit te masterplaneve , planeve rregulluese e studimeve pjesore , projekte arkitektonike e konstruktive te objekteve civile –industriale,turistike.

Konsulence, ekspertize dhe oponente teknike sipas kategorive te licenses se drejtuesve teknike dhe te vet shoqerise.

Konsulence per vleresim teknik dhe ofertes per tenderat publik dhe privat ne fushen e ndertimit.

Konsulence per hartimin e manualeve te cmimeve te punimeve te ndertimit e makineri pajisjeve.

Mbikqyrje, kolaudim punime ndertimi

Vleresim te ndikimit ne mjedisit, auditim mjedisor

Ekspert privat zjarrfikes (MNZ) ne fushen projektme e mbikqyrje.

Vleresim te pasurive te paluajtshme.

Projektim, mbikqyrje, kolaudim ne fushen trashegimise kulturore arkitektonike dhe materiale.

Rilevime ne te gjitha shkallet, projektim, fotogrametrik-hartogarafik dhe topografik.

Sherbime te ndryshme ne fushen e ndertimit, veprave hidroteknike, ne administrim, menaxhim ujesjellesa, kanalizimeve te ujrave te zeza, impjante pastrimi te ujit te pijshem dhe venddepozitimeve te mbetjeve te ngurta (urbane),

Projekte dhe Organizime të aktiviteteve ne fushën e turizmit, etj.

Blerje Pajisje per Projektim dhe Mbikqyrje

Projektim, mbikqyrje, kolaudim punime pyllëzimi dhe bimësh bujqesore , gjelberimi e dekori.

Konsulence dhe ekspertiza tekniko, ligjore te fushës se ndërtim, projektim, mbikqyrje, kolaudimit te gjithë llojeve te rikonstruksioneve dhe ndertimit te objekteve.

Ne fushën e tregtisë import – eksporti, me shumice dhe pakice, te mallrave industriale, ushqimore, bujqësor dhe blegtorale, veshmbathje, konfeksione, prodhime e tregtim te materialeve te ndërtimit, automjeteve, makinerive, pajisjeve 3 hidrosanitare, mobiljeve, lendeve te përpunuara dhe te papërpunuara , te bimëve medicinale, te lendeve drusore, plastike, duraluminit.

Ne fusha te tjera: agjenci për shitblerje, dhënie me qira te pasurive te tundshme dhe te patundshëm, agjensive per administrimin e shërbimeve te mirëmbajtjes e pastrimit ne ndërtesa individuale e kolektive, zyra, hotele etj. Hartim Studimesh per vleresimin e ndikimit ne mjedis (VNM)

NENI 5

KOHEZGJATJA

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar

KREU II

KAPITALI

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe është i perbere nga 1 kuote. Kapitali eshte i zoteruar 100% nga ortaku i vetem z. **Levend Harizi**

Kapitali i mësipërm është i nënshkruar teresisht nga ortaku i vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë:

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Ortakut te Vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve.

Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANI VENDIMMARRES

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise, qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj.

Ortaku u vetem brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratori.

NENI 9

NDRYSHIMET E STATUTIT

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i Vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 10

ADMINISTRIMI

Administrator i shoqerise eshte emeruar z. **Levend Harizi**

Administratori ushtron funksionin e tij per nje periudhe kohe 5 vjecare qe nga momenti i emerimit, me te drejte riemerimi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

NENI 11

KOMPETENCAT

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave, qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve, qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin, qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Administratorit nuk i lejohet te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj per parardhnie si dhe te behen dorezenes ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Klauzolat e ketij statusi, qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet.

NENI 12

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 01 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 13

SHPERNDARJA, PRISHJA E SHOQERISE

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar sic mund te jene:

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Me vendim te ortakut te Vetem.

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim mer shkrim ne te cilen parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 (nje) apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likujdim ".

NENI 14

BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjore ne fuqi dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

NENI 15

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem themelues, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM

Levend Harizi


